

KONTRATE

SHIT - BLERJE TE AKSIONEVE

Sot, më datë 27.01.2025 (dymije e njezete e peste), sa me poshte u paraqiten palet:

Z. Alban Jaho, i biri i Nuri, i dtl. 31.05.1969, lindur ne Tirane dhe banues ne adrese: Rr. "Janos Hunyadi", Pall.nr.32, Ap.4, Tirane, identifikuar Leternjoftimin Nr.033575071, Nr.Personal G90531044P (*referuar si "SHITESI I AKSIONEVE"*)

Zj. Irida Jaho, (*bashkeshorte ligjore*) e bija e Ismet, e dtl.15.09.1972, lindur ne Tirane dhe banuese ne ne adrese: Rr. "Janos Hunyadi", Pall.nr.32, Ap.4, Tirane, identifikuar me Leternjoftimin Nr.034028937 dhe Nr.Personal H25915169D (*referuar si "SHITESI I AKSIONEVE"*)

Dhe

Shoqeria "ALBSEA TRANSPORT" Sh.p.k, person juridik shqiptar me seli: Lagjja nr. 3, Objekt me nr. pasurie 3/375+1-1, Hyrja 1, Apartamenti 1, Durres, me NUIS K31714513G, përfaqësuar nga administratori z. Froid Jasimi, banues ne Durres, i dtl. 04.10.1999, identifikuar me ID nr. 032957605 dhe Nr.Personal J91004087O, (*referuar si "BLERESI I AKSIONEVE"*)

Kjo kontratë shitblerje eshte lidhur duke patur parasysh vullnetin e lire dhe te plote te palëve për transferimin e aksioneve qe pala shitesë zoteron ne shoqërine tregtare DIGIT-ALB Sh.a.

Sa më sipër, palët ranë dakort për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës me termat si më poshtë vijon :

Shitesi gezon te drejten e plote dhe ekskluzive te pronesise dhe zoterimit te 5798.510 numer aksione te zakonshme te cilat perfaqesojne 2.52 % (dy pike pesedhjetë e dy perqind) te kapitalit aksionar te shoqerise DIGIT-ALB sh.a, e themeluar dhe organizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NUIS K41719004D.

1. Shitesi transferon nepermjet shitjes dhe dorezon pronesine e plote te aksioneve te cilesuar ketu me siper, konkretisht te 5798.510 numer aksione te zakonshme te cilat perfaqesojne 2.52 % (dy pike pesedhjetë e dy perqind) te kapitalit te shoqerise DIGIT-ALB sh.a, dhe te gjitha te drejtat qe ai gezon si



aksionar, ja transferon/kalon bleresit, i cili pranon ti bleje kundrejt cmimit ne vleren **prej 252 000(dyqind e pesedhjete e dy mije)Euro.**

2. Bleresi do te paguaje cmimin e shitjes me date 30.06.2025 ne llogarine bankare te shitesit, konkretisht:
 - Emri Bankes: Union Bank sh.a.
 - Titullari i llogarise: Alban Jaho.
 - IBAN. AL70214112090117100446650120.
3. Shitesi ne kete menyre deklarone dhe bleresi pranon se aksionet transferohen sipas gjendjes aktuale sot, te cilat rezultojne se nuk jane vendosur peng apo kufizim tjetër te kesaj natyre, sipas verifikimit dhe Ekstraktit te QKB-se.
4. Nëpërmjet realizimit të këtij veprimi juridik, bleresi do të fitojë cilësinë e aksionerit ne masen prej 5798.510 numer aksione te zakonshme te cilat perfaqesojne 2.52 % (dy pike pesedhjete e dy perqind) te kapitalit te shoqerise DIGIT-ALB sh.a, ne daten e nenshkrimit te kontrates.
5. Shitesi pas transferimit te mases totale te aksioneve tek bleresi, do te humbasi cilesine e aksionarit ne shoqeri, duke humbur te drejten e pronesise se mases se aksioneve te citura me lart, respektivisht me date 27.01.2025.
6. Bleresi me perfitimin e aksioneve nepermjet blerjes sipas kushteve te kesaj kontrate perfundimisht do te zoteroje 24205.39 numer aksione, qe perbejne 10.52% (dhjete pike pesedhjete e dy perqind) te kapitalit te shoqerise DIGIT-ALB sh.a
7. Pas transferimit te aksioneve, bleresi merr persiper personalisht apo nga ndonje person i autorizuar prej tij apo nga administratori i shoqerise "Digit Alb" sh.a, te paraqitet dhe te regjistroje kete kontrate prane Qendres Kombetare te Biznesit si dhe Qendres se Regjistrimit te Aksioneve per te kryer veprimet e nevojshme te transferimit/kalimit te aksioneve ne favor te bleresit ne masen e cituar me lart.
8. Kjo Kontrate hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimit te saj nga palet respektive.
9. Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm sipas marrëveshjes së shkruar të përfunduar midis Palëve.




10. Cdo mosmarreveshje qe mund te lindin ne lidhje me ekzekutimin dhe interpretimin e kesaj kontrate, palet do te ofrohen ta zgjidhin midis tyre, ne te kundert Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane, do te jete kompetente per zgjidhejn e saj.
11. Kjo Kontratë është e përbërë nga 3 (tre) flete, dhe është përgatitur në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

PALËT

SHITESI

Z. Alban Jaho



Zj. Irida Jaho



BLERESI

Shoqeria "ALBSEA TRANSPORT" sh.p.k
Administratori

Z. Froid Jasimi

